



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE VLORE

NOTER MIRSIDA R. KALESHA
ADRESA Rr. "Sheshi Avni Rustemi",
Lagjja "Hajro Çakërrri", pall."Objekti
1", kati tretë, zyra nr.5, Vlorë
TEL: 692044999

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 535


Nr. koleksioni: 198

Vlore më 14/07/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10.03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2022061960024330758



A2022061960024330758

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "TECHNO BUILD 2018 SH.P.K)**

Sot, më datë 14 Korrik 2022, para meje Noteres MIRSIDA R. KALESHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Vlore, Rr. "Sheshi Avni Rustemi", Lagjja "Hajro Çakërr", pall."Objekti 1", kati tretë, zyra nr.5, Vlorë, u paraqitën personalisht:

Pala shitëse: Arentina Liçaj, atësia Kastriot, amësia Merzine, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. 71; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 22/08/1986, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036721350 dhe nr. personal I65822075R. **Pala e parë (në vijim do të përmendet si Ortaku shitës)**

Pala blerëse: Aleksandros Liçaj, atësia Blerdi, amësia Sonila, shtetas Shqiptar, lindur në Athinë, Greqi (GRC) dhe banues në Tiranë, me adresë B.Curri; Nd. 004; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 21/07/2003, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035040991 dhe nr. personal K30721045A. **Pala e dytë (në vijim do të përmendet si Ortaku i ri blerës)**

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Techno Build 2018" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Hyrje:

- a) Ortaku shitës Arentina Liçaj është zotëruar i një (1) kuote, që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë "TechnoBuild 2018" Sh.p.k. e regjistruar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT L81505028B.
- b) Shoqëria është e lirë nga çdo hipotekim barrë kërkesë ligjore mbi pasurinë, garanci detyrim interesa sigurimi të drejta të personave të tretë ose pretendime të tjera ose çdo lloj barre e tillë.
- c) Shoqëria TechnoBuild 2018 shpk përbëhet nga dy ortak, ortaku Arentina Liçaj me 1 kuotë e barazvlefshme me 30% të kapitalit dhe ortaku Gjiguria shpk me pjesëmarrje 1 kuotë e barazvlefshme me 70% të kapitalit të Shoqërisë. Shoqëria TechnoBuild 2018 shpk, e përfaqësuar nga ortakët kanë marrë Vendimin e mbeldhjes së ortakëve për miratimin e shitjes së kuotës e zotëruar nga Arentina Liçaj tek ortaku i ri Aleksandros Liçaj sipas kushteve dhe afateve te percaktuara në këtë kontratë.
- d) Me nënshkrimin e kësaj kontrate ortaku Arentina Liçaj transferon nëpërmjet shitjes 1 kuotë, që përbën 30% të kapitalit të Shoqërisë "TechnoBuild 2018" Sh.p.k. në favor të blerësit, ortaku Aleksandros Liçaj.

Në dëshmi të kontratës së mësipërme, palët bien dakort si më poshtë:

1. Përfaqësimet dhe Garancitë e palëve

Palët këtu përfaqësojnë dhe garantojnë njera tjetrën në këtë datë të kontratës, si më poshtë:



A2022061960024330758

Autorizimi : Secila palë ka fuqinë e plotë korporative dhe autoritetin të ekzekutojë dhe kalojë të drejtat me këtë kontratë dhe të gjithë dokumentat e tjera të nevojshme për transaksionin e parashikuar në këtë Kontratë. Pjesë përbërëse e kësaj Kontrate do të jetë vendimi i Asamblese së Ortakëve të Shoqërisë «TechnoBuild 2018 Sh.p.k. nr. 12 datë 12.07.2022, me të cilin lejohet transferimi i kuotave të kapitalit tek Ortaku ri.

Pa konflikt: ekzekutimi, kalimi i të drejtave dhe permbushja e detyrimeve nga secila Palë e kësaj Kontrate dhe konsumimi nga secila Palë e transaksionit të parashikuar në të, nuk do të duhet të :

- (i) dhunojë, të shkaktojë konflikt me rezultat shkelje nga cilado Palë të ndonjë prej klauzolave të dokumentave të regjistrimit të secilës Palë,
- (ii) dhunojë, të shkaktojë konflikt me rezultat shkelje nga cilado Palë të ndonjë prej klauzolave të ndonjë marrëveshje në të cilën cilado Palë është palë ose çdo detyrim tjetër ligjor ndaj të cilit cilado Palë është e detyruar,

2. Kushtet dhe termat e shitjes së kuotave

2.1 Ortaku Arentina Liçaj do të shesë nëpërmjet kësaj kontrate tek Ortaku i ri Aleksandros Liçaj 1 kuotë, që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë “TechnoBuild 2018” Sh.p.k., me kushtet dhe termat e shitjes se kuotave si vijon:

- Çmimi i shitjes së 1 kuote që përbën 30% të kapitalit në total është **10,000Lekë (dhjetëmijë lekë)**.
- Blerësi Aleksandros Liçaj e ka paguar sipas paragrafit të mësipërm plotësisht cmimin e shitjes pranë shitësit të Shoqërisë “TechnoBuild 2018” Sh.p.k., kesh me para në dorë, dhe shitësi deklaron se ka marrë çmimin e plotë të shitjes dhe nuk ka asnjë pretendim.

2.2 Me nënshkrimin, noterizimin dhe regjistrimin e kësaj kontrate në QKB (Qëndrën Kombëtare të Biznesit), ortakët e Shoqërisë “TechnoBuild 2018” Sh.p.k. do të jenë si më poshtë :

- **Aleksandros Liçaj, ortak i shoqërisë me 1 kuotë që zoteron 30% të kapitalit të Shoqërisë “TechnoBuild 2018” Sh.p.k.**
- **Gjikuria shpk, ortak i shoqërisë me 1 kuotë që zotëron 70% të kapitalit të Shoqërisë TechnoBuild 2018 shpk**

3. Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotës që po transferon, nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga cdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

4. Heqja dorë nga të drejtat

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë nga 1 kuotë, 30% e kapitalit të Shoqërisë TechnoBuild 2018 Sh.p.k., pas nënshkrimit të kësaj kontrate duke mos patur më asjë të drejtë dhe detyrim që rrjedh nga pronësia e kuotës.

5. Konfidencialiteti

Palët bien dakort që gjithë informacioni, përfshirë pa kufizim informacion teknik apo biznesi, i marrë prej tyre nga njeri tjetri, ngelet i brendshëm dhe konfidencial dhe nuk do të jepet nga ata tek ndonjë palë e tretë .

6. Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Ligji i zbatueshëm: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij; Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.



A2022061960024330758

Juridiksioni: Gjykata kompetente e Shqiperise do te kete juridiksionin per te zgjidhur çdo mosmarreveshje qe mund te linde nga ose ne lidhje me kete Kontrate siç siperpermendet, dhe Palet bien dakort t'i nenshtrohen nje juridiksioni te tille.

7. Të ndryshme

Amendamentet. Asnjë shtese ose ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete detyrues ndaj seciles Pale nese nuk eshte me shkrim dhe ekzekutuar sipas rregullave prej Paleve ne te, ne te njejten menyre si ne ekzekutimin e Kontrates.

Njoftim: Çdo njoftim sipas kësaj Kontrate duhet të jetë me shkrim në Shqip dhe duhet gjykuar të jetë rregullisht i dhënë për të gjitha qëllimet

a) kur merret ose 7 (shtatë) ditë pas postimit të tij me postë rekomande ;

b) me transmetimin e tij i konfirmuar si i tillë me faks ose e-mail, me kopje nga posta;

Adresa : Çdo njoftim që do të lëshohet sipas kësaj Kontrate do të gjykohet si e dërguar në mënyrën e duhur nëse ajo është dërguar në adresën e palëve shkruar në fillim, lart.

Neni 8

ANEKSET E KONTRATËS

8.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 12, datë 12.07.2022, bashkëlidhur vërtetim nënshkrimi
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "TechnoBuild 2018" Sh.p.k.. datë 12.7.2022
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Certifikatë familjare e palës Shitëse;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 9

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

9.1 Kontrata e Shitjes të kuotës të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit. Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë" i ndryshuar, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

BLERES

Aleksandros Liçaj

Aleksandros Liçaj
SHITES

Arentina Liçaj

Arentina Liçaj

Notere
MIRSIDA R. KALESHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE VLORE

NOTER MIRSIDA R. KALESHA
ADRESA Rr. "Sheshi Avni Rustemi",
Lagjja "Hajro Çakërri", pall."Objekti
1", kati tretë, zyra nr.5, Vlorë
TEL: 692044999

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 531

Vlore më 14/07/2022

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2022061960035118366


**VENDIM No.12 I ASAMBLESE
SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TECHNOBUILD 2018 SH.P.K**

Sot me date 12.07.2022 ne seline e shoqerise u mblodh "Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve" te shoqerise TechnoBuild 2018 SHPK

1. **Ortaku Shoqëria Gjiguria shpk person juridik i pajisur me Nuis J62903456H, e perfaqësuar nga administratori Z. Florenc Gjiguria, atësia Milo, amësia Kani, shtetas Shqiptar, lindur në Memaliaj, Tepelene dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031406006 dhe nr. personal H30112106D**
 2. **Ortaku Znj. Arentina Liçaj, atësia Kastriot, amësia Merzine, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. 71; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 22/08/1986, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036721350 dhe nr. personal I65822075R,**
- **Ortakët e mbledhur përfaqësojnë 100 % të kapitalit të shoqërise TechnoBuild SHPK. Asambleje eshte thirrur per te marre vendimin me rend dite si me poshte:**
1. Transferimin nepermjet shitjes se 1 kuote që përbën 30% të kapitalit të zotëruara nga ortaku Arentina Liçaj tek ortaku i ri blerës Aleksandros Liçaj.
 2. Emërimin e ortakut të ri Aleksandros Liçaj, ortak i Shoqërisë TechnoBuild 2018 shpk me 1 kuote qe perfaqeson 30% të kapitalit.
 3. Autorizojmë Administratorin Blerdi Liçaj të bëj ndryshimet pranë QKB.
- **Pas diskutimit sa me sipër, asambleja e pergjithshme e ortakeve:**
- Transferimin nepermjet shitjes se 1 kuote që përbën 30% të kapitalit të zotëruara nga ortaku Arentina Liçaj tek ortaku i ri blerës Aleksandros Liçaj.
 - Emërimin e ortakut të ri Aleksandros Liçaj, ortak i Shoqërisë TechnoBuild 2018 shpk me 1 kuote qe perfaqeson 30% të kapitalit.
 - Autorizojmë Administratorin Blerdi Liçaj të bëj ndryshimet pranë QKB.


ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE TechnoBuild 2018 SHPK

Ortaku
Gjiguria shpk
Z. Florenc Gjiguria



Ortaku

Arentina Liçaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
NOTER MIRSIDA R. KALESHA



V2022061960035118366

DATE 14/07/2022
NR REP 531

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 14.07.2022, para meje Noteres MIRSIDA R. KALESHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Vlore, Rr. "Sheshi Avni Rustemi", Lagjja "Hajro Çakëri", pall."Objekti 1", kati tretë, zyra nr.5, Vlorë, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

1. **Shoqëria GJIKURIA**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS J62903456H, me seli në Tiranë me adresë Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Prane Gardes Se Republikes, Pallati Kontakt, Mbi Union Bank, përfaqësuar nga Administratori Florenc Gjiguria, atësia Milo, amësia Kani, shtetas Shqiptar, lindur në Memaliaj, Tepelene dhe banues në Tiranë, me adresë Selite; Nd. 178; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 12/01/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037737790 dhe nr. personal H30112106D.
2. **Arentina Liçaj**, atësia Kastriot, amësia Merzine, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. 71; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 22/08/1986, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036721350 dhe nr. personal I65822075R

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "Vendim nr. 12 i Asamblese se ortakeve te Shoqerise TechnoBuild 2018 date 12.04.2022", bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë" i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

MIRSIDA R. KALESHA



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20220714152814529
Data e Rezultatit te Kerkimit: 14.07.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 3:28:14PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-669-195
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ARENËTINA KASTRIOT LICAJ
TECHNOBUILD 2018 SH.P.K.


Arjola Buresi



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L81505028B
2. Data e Regjistrimit	05/03/2018
3. Emri i Subjektit	TechnoBuild 2018
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	28/02/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 28/02/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Korce Korçe KORCE Prane Pazarit të Vjeter, ne Godinen e quajtur Hami Gjelit, me Z.Kadastrale 8564
8. Kapitali	1.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Aktivitet në fushen e ndertimeve civile, objekte shërbimi dhe banimi; rrugë; ura; porte; trase hekurudhore; terminale; hidrocentrale; veprave bonifikuese; vepra kulturore, parkimeve nëntokesore dhe cdo ndërtim tjetër; punime ndërtimore në nentokë dhe në lartësi. Rikonstruksion i ndertimeve civile dhe restaurime të objekteve historike, kulturore, fetare dhe objekteve të tjera. Studim, projektim i ndertimeve të ndërtesa e publike, rrugëve, urave, tuneleve, traseve hekurudhore, veprave bonifikuese, centrale, objekte turistike, terminale, parkime nëntokesore, industriale, objekte të kulteve, realizim të studimeve urbane, restaurime, prodhim të materiateve të ndërtimit. Aktivitet në fushen e pasurive të paluajtshme si blerje, shitje, marrje me qira, menaxhimi i pasurive të paluajtshme. Aktivitet në menaxhimin e qendrave të biznesit; qendrave tregtare; terminaleve; porteve; aeroporteve; dhe shërbimeve të ngjashme. Aktivitet në fushen e financimit, investimit dhe menaxhimit të projekteve koncesionare; partneritet publik privat; partneritetit duke krijuar shoqëri të thjeshta; parteritet me shoqëri shqiptare dhe/ose të huaja. Shoqëria kryen cdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj duke përfshirë edhe veprime për shitblerje sendesh të luajtshme e të paluajtshme, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera. Blerja, shitja dhe administrimi i aksioneve, bono, të letrave me vlerë të borxhit publik dhe

	<p>privat ne pergjithesi, te aksioneve ne kompani, letra me viere, pasurive financiare, industriale, tregtare dhe pasurive te paluajtshme. Ushtrimin e aktiviteteteve Bar-Lokale, restorant, hoteleri turizem, akomodim, katering, import eksport, tregtimi me shumice te artikujve te ndryshem industrial, ushqimore, materiale ndertimi. Ushtrimi i veprimtarise turistike si tour - operator, si agjensi turistike udhetimi, te transportit per udhetare, guide perkthyes, turizem. Ne ushtrimin e ketyre aktiviteteteve kompania mund te perdore dege, zyra, agjenci dhe depo ne te gjithe vendin si edhe jashte vendit. Shoqeria mund te permbushe te gjitha operacionet tregtare, ne fushen e pasurive te paluajtshme, financiare dhe industriale qe do te konsiderohen te nevojshme nga organi administrativ ose te dobishme per te arritur qellimin e shoqerise. Shoqeria mund te kryeje transaksione financiare, dhe te pasurive te patuajtshme qe do te konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimit te shoqerise, te marre pjese ne shoqeri te tjera me objekt te njejte, te ngjashem apo qe lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe te jape garanci per hua si dhe garanci hipotekore ne favor te ortakeve dhe ne favor te te treteve.</p>							
<p>10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit</p>	<p>Blerdi Liçaj Nga: 28/02/2018</p>	<p>Deri: 28/02/2023</p>						
<p>11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>								
<p>12. Ortakët 12.1 Vlera e kapitalit 12.2 Numri i pjesëve 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)</p> <p><i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i></p>	<p>Arentina Liçaj</p> <table border="1" data-bbox="699 1339 1461 1480"> <tr> <td>Para: 300,00</td> <td>Natyre:</td> </tr> <tr> <td>1,00</td> <td></td> </tr> <tr> <td>30,00</td> <td></td> </tr> </table>		Para: 300,00	Natyre:	1,00		30,00	
Para: 300,00	Natyre:							
1,00								
30,00								
<p>13. Ortakët 13.1 Vlera e kapitalit 13.2 Numri i pjesëve 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)</p> <p>13.4 Komente (nëse ka)</p>	<p>GJIKURIA</p> <table border="1" data-bbox="699 1624 1461 1765"> <tr> <td>Para: 700,00</td> <td>Natyre:</td> </tr> <tr> <td>1,00</td> <td></td> </tr> <tr> <td>70,00</td> <td></td> </tr> </table>		Para: 700,00	Natyre:	1,00		70,00	
Para: 700,00	Natyre:							
1,00								
70,00								
<p>14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit</p>								
<p>15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht</p>	<p>Emri Tregtar: TechnoBuild 2018 E-Mail: technobuild2018@outlook.com</p>							

16. Statusi:	Aktiv
--------------	-------

Datë: 14/07/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web